



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Lezhe, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “RIKONSTRUKSIONI I PALLATIT NR. 21 DHE GODINES SE ISH-BANKES SE SHTETIT”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 45000000-7

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 16,666,601.64 (gjashtembedhjetë milion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e një *pikë* gjashtedhjetë e katër) Lek pa TVSH.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit (Shtojcat).

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe kerkohet nje operator ekonomik i cili te kete minimumin e kerkuar duke marre ne konsiderate objektin e kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.2** Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar ne ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.3** Operoret Ekonomike ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2022 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2022.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet*

*te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatorët Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore;

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë siper marrje;
2. Leje për kryerje punimesh
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarët e bashkimit të cilët ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

**2.3.2** Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

#### **PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI**

**NP-3 B** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

#### **PUNIME SPECIALE NDERTIMI**

**NS-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve

**NS-4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

**NS-14 A** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kritere të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton *“Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve në preventivin e hartuar nga projektuesi pasi aktivitetet kryesore që do të bëjë Kontraktori për perfundimin me sukses të punimeve sipas kontratës në këto objekt janë:

- Mobilizimi
- Furnizimi, Transporti dhe Magazinimi i Materialeve
- Aktivitetet e Punimeve Ndërtimore
- Aktivitetet e Punimeve Elektrike
- Mbrojtja e Punimeve, ambientit dhe publikut
- Kontrolli laboratorik, Testimi dhe Kontrolli i cilësisë së materialeve

Klasat janë përcaktuar referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008, në proporcion me preventivin e punimeve dhe fondin limit dhe janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

<b>Kategoria e Licenses</b>	<b>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>	<b>Vlera e punimeve në preventiv, sipas kategorisë përkatëse</b>
<b>NP- 3 B</b> Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Ne preventiv parashikohen punime për rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, murature, suvatime dhe bojatisje të brendshme dhe të jashtme etj.	16,666,601.64 leke
<b>NS-1 A</b> Punime për prishjen e ndërtimeve	Ne preventiv parashikohen punime për Prishje/kruarje/pastrim suvatimi tavan + mure të brendshme, Prishje shtresa betoni (tarace), Prishje mur tulle me pastrim, Prishje shtresa betoni (shtresa, pllakat e dyshemese, korrimano), Prishje plintuse pllake grez etj.	566,267.04 leke

NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri,	Preventivi parashikon punime ne tarraca dhe shtresash suvatimi dhe mure	11,053,476.8 leke
NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	Preventivi parashikon punime instalime elektrike.	597,296.80 leke

**2.3.3** Operoret Ekonomike duhet te kene një punësim mesatar të paktën 20 (njetzet) personave të siguruar për periudhen Nentor 2022 - Janar 2023.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit te mesiperem per numerin minimal te punonjesve duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, raportit teknik, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.3.4** Operatoret Ekonomike duhet te kene pjese te stafit teknik te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise si me poshte:

Inxhinier Ndërtimi	2 (dy)	Diplome Universitare
Inxhinier Elektrik	1 (nje)	Diplome Universitare

-Per stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare si dhe të figurojnë ne listepagesat e kompanise se minimalisht per periudhen Nentor 2022 - Janar 2023.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e ketyre punimeve. Kriteri i mësipërm ne lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, date 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar parashikohet se: “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.”

Sa më sipër, duke marre parasysh natyren e puneve te objektit te prokurimit duke qene se jane dy godina te ndara, ka perzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, te cilet jane te nevojshem per realizimin e punimeve. Per me teper duke qene se keto punime jane te nje rendesie te vecante dhe ne te njejten kohe konsistojne ne nderhyrje ne nje objekt civil, i cili shfrytezohet nga banoret e pallatit, shikohet e nevojshme qe te kerkohen specialist te fushave inxhinierike si: Inxhinier Ndërtimi dhe Inxhinier Elektrik.

Bazuar ne preventivin e punimeve parashikohen te realizohen punime te natyres ndertimore dhe elektrike si dhe kontrolli i nevojshem ne te gjithë etapat e punes qe kerkohe te realizohet, kerkon minimalisht inxhinieret e kerkuar.

**2.3.5** Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- Teknik Ndertimi 2 (dy) Diplome shkolles mesme

- Teknik Elektronik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Karpertier	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Suvatues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Plakashtues	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Bojaxhi	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hidroizolues	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	5 (pese)	Leje Drejtimi

Operatori ekonomik duhet te paraqese per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome e shkolles mesme/ Çertifikate trajnimi/ Deshmite profesionale/Leje Drejtimi, sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Nentor 2022 - Janar 2023.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Per stafin mbështetës Teknik ndertimi, Teknik elektronik, Teknik Elektrik, Karpertier, Suvatues, Plakashtues, Bojaxhi, hidroizolues dhe shofer, në lidhje me kualifikimet janë parashikuar nivele si Diplome e shkolles mesme/ Çertifikate trajnimi/ Deshmite profesionale/Leje Drejtimi etj, te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar në kuptim të nenit 4, pika 17, të ligjit Nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Po ashtu profilet e kerkuar dhe numri i tyre, janë kerkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, duke marrë në konsideratë edhe zërat konkretë të preventivit të zbatimit të punimeve, volumit te tyre, Raportit Teknik dhe Specifikimet Teknike, si dhe mjeteve qe duhet te jene ne dispozicion, pasi parashikohen punime te natyres per rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, punime ne tarraca, punime shtresash suvatimi dhe mure, punime instalime elektrike etj.

Sa me siper me qellim realizimin e punimeve ne perputhje me specifikimet teknike dhe zbatimin me sukse te kontrates si dhe kontrolli i nevojshem ne te gjithë etapat e punes qe kerkohe te realizohet, kerkon minimalisht stafin e kerkuar.



**2.3.6** Operatoret Ekonomike duhet te kene ne stafin teknik ose mbeshtetes, te certifikuar te paktën:

**2.3.6/a** -1 (nje) punonjes te pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Nentor 2022 – Janar 2023.

**2.3.6/b** -1 (nje) Punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Nentor 2022 – Janar 2023.

**2.3.6/c** -4 (kater) punonjes te paisur me certifikate “Per punime ne lartesi”. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune dhe certifikaten perkatese ose deshmi nga institucione te akredituara si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Nentor 2022 – Janar 2023.

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste

ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Ne lidhje me kërkesen për disponueshmëri e 1 (një) inxhinieri i cili duhet të jete te pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë), që tregojne pjesëmarrjen e tyre në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private eshte bere referuar ligjit nr. 10.237, date 18.02.2010 “Për sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M-ne nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Kjo kerkese eshte ne proporcion me natyrën dhe volumin e kontrates.

Ne lidhje me kërkesen për disponueshmëri e 1 (një) punonjesi te pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, eshte ne proporcion me natyren dhe volumin e kontrates, pasi kemi te bejme me zbatimin e punimeve te shtrira ne territor te shpermdare dhe nen perdorimin e mjeteve te transportit duke e konsideruar nje pune me rrisk te larte per ndodhjen e aksidenteve ne pune. Sqarojme se dhënia e ndihmës së parë fillon nga vendi i ngjarjes dhe vazhdon gjatë transportit deri në vendosjen e të lënduarit dhe të sëmurit në institucionet mjekësore përkatëse.

Ne lidhje me kërkesen për disponueshmëri e punonjesve te paisur me certifikate “Për punime ne lartesi”, shfaqet e nevojshme, pasi ne zbatimin e punimeve do te punohet ne 2 ndertesa me lartesi 4 kate dhe nevojiten njohuri shtese me qellim parandalimin e rezikut te renies nga lartesite.

Sa me siper duke qene se punimet do te kryhen ne objekte civile me shume kate, nevojitet angazhimi i punonjesve te certifikuar dhe me njohuri te posacme sipas kerkesave te mesiperme.

### 2.3.7 Operatoret Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes nga 3.5 deri ne 5 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	2
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes nga 5 deri ne 10 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	2
3	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 12-18 ton	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
4	Autobetoniere	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	1
5	Skeleri	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	m2	1500
6	Betoniere kantieri	Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi	cope	2

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndërsa për mjete të marra me qera/kontrata bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera/ Kontrata bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës/ Kontrata Bashkëpunimi.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qera ose kontrata bashkëpunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

### **2.3.10 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë e furnizimit për materialet si më poshtë:**

#### **2.3.10/1 Për Bojrat**

- Kontrata paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

#### **2.3.10/2 Për Materialet e termoizolimit, hidroizoluesë dhe suvase:**

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

### **2.3.10/3 Per Materialet Elektrike:**

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter vendoset bazuar në zerat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rëndësi se vecante të objektit të prokurimit, duke marrë në konsideratë se godina është një objekt civil që shfrytëzohet nga banoret.

Meqenese punimet do të kryhen në një objekt që kërkon kujdes të veçantë për shkak të frekuentimit nga nga banoret e pallatit shfaqet e nevojshme që për mallrat që do të perdoren në realizimin e punimeve, Autoriteti Kontraktor të garantohet që këto mallra furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar.

**2.3.11** Operoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **OHSAS 18001:2015**, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 14001:2015**, mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalentin e saj.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar natyrës së veçantë, vendndodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

Njesia pergjegjese ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne specifikimet teknike argumenton se nuk ka permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

#### **NJËSIA E PROKURIMIT:**